



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverballi i mbajtur më 28 dhjetor 2016, në mbledhjen e XXXVI-të (tridhjetegjashhtë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit theksoi, konsideroj se thirrja dhe materiali për këtë mbledhje ju është dërguar me kohë andaj mund të vazhdojmë me punë. Gjithashtu Kryesuesi njoftoj dhe i ftoj këshilltarët e Kuvendit në një koktej të organizuar pas kësaj mbledhje me rastin e përfundimit të këtij viti.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës kam disa propozime për të cilat kërkoj të hedhën në votim pavarësisht rezultateve të votimit, ngase mendojmë se janë propozime shumë të arsyeshme.

Propozim i parë është, si vijon; Armela Segashi 14 vjeçarja nga Komuna jonë që banonte në Munchen të Gjermanisë, humbi jetën së bashku me tetë persona tjerë tragjikisht gjatë një sulmi terrorist më 22 korrik 2016. Vrasja e saj pikëlloi të gjithë qytetarët e vendit tonë e në veçanti Komunën e Podujevës. Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK-së – Dega në Podujevë, i propozon Kuvendit të Komunës së Podujevës që me emrin Armela Segashi të emërohet një nga këto propozime, ne i japim disa sugjerime mirëpo aty ku ka hapësirë ligjore dhe të jetë e mundur; jemi në dijeni se emërtimet e rrugëve janë bërë dhe ekzistojnë edhe emrat rezervë, nuk jemi që të ndryshohet ndonjë emër ekzistues sepse tani veç jemi në proces të vendosjes së tabelave por kërkojmë që së paku emri Armela Segashi të futet në listën e emrave rezervë në mënyrë që në të ardhmen kur të jetë e mundshme ndonjëra prej rrugëve të qytetit të Podujevës të ketë këtë emër, si propozim i dytë është që ura e re e ndërtuar mbi lumin Llap e cila simbolizon miqësinë në mes të popullit tonë dhe atij gjerman të mbaj emrin Armela Segashi, pastaj sugjerim tjetër është ndonjë çerdhe apo kopsht fëmijësh të mbaj këtë emër pasi që mosha e saj ka qenë e re.

Me motivacion, -Armela Segashi humbi jetën tragjikisht nga sulmi terrorist në shtetin e Gjermanisë, shtet ky i cili është aleat i yni dhe i cili ka bërë aq shumë për popullin dhe vendin tonë. -Do të jetë kontribut i veçantë në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar të çfarëdo ngjyre. -Do të jetë kontribut në lidhjen e popullit tonë me atë Gjerman që aq shumë ka bërë për vendin

tonë, një ashtu edhe për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe po bënë zgjidhje për problemet e shumë popujve në mbarë botën por edhe për popullin tonë. -Do të jetë veprim vlerësues për mbështetjen e dhënë nga ana e organeve shtetërore të Gjermanisë në rastin e vrasjes së Armela Segashit. -Do të jetë mesazh i qartë se populli i vendit tonë është kundër çfarëdo dhune qoftë ajo. -Do të jetë veprim vlerësues nga ana e Kuvendit të Komunës së Podujevës për qytetarët e saj. -Do të jetë veprim mbështetës moral edhe për familjen Segashi.

Propozimi ose çështja e dytë, edhe dje në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar rreth përfaqësimit politik në Komitete dhe Komisione tjera të Kuvendit të Komunës ku PDK në çdo mbledhje është munduar që në formë politike – bashkëpunuese të zgjidh dhe të gjejë gjuhë të përbashkët politike me Kryesuesin e Kuvendit dhe me partitë tjera politike që janë të përfaqësuara në këtë Kuvend, mirëpo deri tani nuk kemi gjetur ndonjë bashkëpunim nga ana juaj. Unë si shef i Grupit të këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK-së, në këtë seancë kërkoj që të hedhen në votim emrat në vijim për anëtarë të komiteteve dhe komisioneve si në vijim, dhe atë Sabri Hamiti në Komitetin për Komunitete, Fatmir Rudari në Komisionin për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, si dhe Flakron Gashi në Komisionin e ankesave. Pra i nderuari Kryesues në mbledhjen e KPF-së e kemi mbështetur të diskutojmë për pikat e rendit të propozuar të ditës për këtë seancë, mirëpo kemi edhe propozimet e lartcekura për përfshirje në kuadër të kësaj seance.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, sa i përket propozimit të parë të këshilltarit parafoles z.Rafet Llapashtica, më duhet t'ju informoj se ka kohë që ne kemi proceduar një kërkesë të tillë në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për t'i vë emrin Armela Segashi, Çerdhes publike e cila aktualisht mban emrin "Drita". Presim që të marrim përgjigje pozitive dhe besoj se shpejti do ta kemi emërtimin e Çerdhes me emrin Armela Segashi.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj Nënkryetarin e Komunës për këtë njoftim rreth kësaj çështjeje për të cilën konsideroj se asnjë nga ne nuk kemi rezerva por jemi të pajtimit të gjithë rreth propozimit por edhe asaj që Nënkryetari na njoftoj, propozim për të cilin mendoj se nuk ka nevojë fare të hedhet në votim sepse jemi unanim dhe nuk ka kurrfarë problemi. Sa i përket çështjes së dytë të cilën e ngriti z.Rafet Llapashtica, konsideroj se përderisa ekzistojnë vendimet përkatëse të Kuvendit të Komunës, në bazë të proceduarve që propozohen pikat e rendit të ditës për një mbledhje të radhës, paraprakisht duhet të ulen shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, sepse nuk mund të hedhim në votim emra të propozuar ndërsa në anën tjetër të heqim emra tjerë, kështu siç u propozua. Kështu që lidhur me këtë çështje, kurdo që dëshironi ose në mbledhjen e radhës, mbajmë një takim shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe unë si Kryesues i Kuvendit ku edhe mund të jepen propozime të tilla, e them këtë sepse për të bërë ndryshime në përbërjet e trupave të Kuvendit duhen zëvendësime përkatësisht për të futë dikë duhet heqë dikë tjetër, e që mund të mos pajtohen të tjerët me këtë formë. Propozimet e lartcekura mund t'i hedh në votim por mendoj se vetëm do të komplikohet situata, andaj propozoj që në muajin e ardhshëm të mbajmë një takim shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe unë, ku mund të konsultohemi, të marrim propozimet dhe të arrijmë deri te një marrëveshje paraprake ngase kështu siç u propozua që drejtpërdrejtë të hedhet në votim nuk mendoj se është zgjidhje marrë parasysh se si mund jetë rezultati i votimit, andaj nëse pajtoheni me këtë, vazhdojmë me punë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuari Kryesues unë kërkoja të hedhet në votim dhe kërkoj sërish të hedhet në votim, dhe duhet të hedhet në votim propozimi i cekur ndërsa qëndrimi është ai që është. Dëshiroj të marrë mendimin nga të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit kush është për ose kundër përfaqësimit të anëtarëve të PDK-së në Komitetet dhe komisionet përkatëse të Kuvendit. Pra ju si Kryesues i Kuvendit keni obligim ligjor të vëni në votim propozimin e tre emrave për përfaqësim në Komitete dhe komisione të Kuvendit, kurse si do të votojnë këshilltarët,

për apo kundër, është e drejtë demokratike e secilit, ne nuk kemi biseduar apo nuk kemi ndërhyrë me asnjë subjekt politik në mënyrë që ata të votojnë këto ndryshime, mirëpo propozimi të hedhet në votim në mënyrë që secili nga Grupet e këshilltarëve të jap qëndrimet dhe arsyetimet e veta.

z.Fidan Rekalju, theksoi, unë ndaj mendimin e njëjtë me Kryesuesin e Kuvendit që sa i përket çështjes së ngritur nga këshilltari parafolës, është mirë që ne shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit paraprakisht të caktojmë dhe të mbajmë në takim në mënyrë që të gjejmë një përgjigjeje rreth këtij modaliteti të propozuar nga këshilltari z.Rafet Llapashtica.

z.Bahri Selimi, theksoi, sa i përket propozimit të z.Rafet Llapashtica tani u hap një debat për të cilin mendoj se mund të jetë ndoshta më i gjatë. U kërkua që të hedhet në votim propozimi për futjen në Komitete dhe komisione disa emra - persona, e që unë nuk e kam të qartë se a është fjala për zëvendësime të personave paraprak apo vetëm të futen persona të rinjë, e them këtë sepse ligjërisht nuk besoj se ka mundësi të rritet numri i anëtarëve të atyre komiteteve dhe komisioneve, ndërsa në qoftë se ekziston mundësia e zëvendësimit, e që nuk u përmend por vetëm u propozuan personat përkatës që të futen në ato Komitete dhe komisione të Kuvendit të Komunës, nuk e di sa është në pajtim me dispozita ligjore kjo çështje, por mendoj se është mirë të sqarohet më gjerësisht kjo çështje në mënyrë që ne të marrim një vendim më konkret dhe më të saktë në këtë drejtim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, secili prej këshilltarëve të Kuvendit këtu përfaqësojmë programe politike sepse të gjithë ne kemi hyrë në këtë Kuvend me një përfaqësim politik, andaj edhe në këtë aspekt Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës kërkon një përfaqësim në Komitete dhe në Komisione me numër të anëtarëve vetëm sa ka hapësirë ligjore, nuk kërkojmë diçka më shumë. Për këtë çështje fjalën e ka Kryesuesi i Kuvendit, nëse ka hasur diçka që është në kundërshtim me atë që e ceka mund të na tregoj, mirëpo ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së kemi vetëm këtë formë që është demokratike dhe konform ligjit, a bëhen zëvendësime të anëtarëve të Komiteteve dhe Komisioneve apo bëhen rritje të numrit të anëtarëve neve nuk na intereson ngase jemi në dijeni se në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa jemi vetëm dy anëtar, në Komitetin për Komunitete nuk kemi fare anëtar e që konsideroj se pagesat bëhen në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe Udhëzimin Administrativ përkatës gjë për të cilën është në dijeni edhe Kryesuesi i Kuvendit, por ai e drejton Kuvendin dhe KPF-në dhe ka përgjegjësi më të mëdha se ne dhe është çështje e Kryesuesit të Kuvendit të zbaton apo jo dispozitat ligjore, Pra ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së vetëm kërkojmë të përfaqësohemi politikisht në Komitete dhe Komisione të ndryshme të Kuvendit të Komunës, andaj edhe njëherë kërkoj të hedhet në votim propozimi përkatës, kurse sa i përket përbërjes dhe zbatimit të dispozitave ligjore përkatëse është qëndrim i Kryesuesit të Kuvendit se si vepron.

z.Flakron Gashi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, Komitetet dhe Komisionet janë pjesë përbërëse e Kuvendit të Komunës, kjo që e ngriti shefi i Grupit nga radhët e PDK-së, ndoshta nuk e ngriti në mënyrën direkte qysh është dashur të ngritët, por si do që të jetë është kërkesë e cila është bërë në vazhdimësi në drejtim dhe adresë tuajën, dhe asnjëherë nuk ka gjetur gatishmëri politike për tu ulur në një tryezë të përbashkët shefat e Grupeve. Këtë nismë është dashur ta marrësh ju Kryesues i Kuvendit sepse nuk i takon ta marrin një hap të tillë përfaqësuesit me dy-tre anëtar apo partitë politike veç e veç. Ka ekzistuar një marrëveshje e cila përcakton qartë proporcionin e forcave dhe për sa asambleistë fitohet një emër ose mandat në njërin nga këto Komitete dhe Komisione, mirëpo realiteti politikë siç e dimë ka ndërruar, por Kryesuesi i Kuvendit ka bazën ligjore në bazë të të cilës duhet t'i thërret shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit në një takim dhe të sjellë një qëndrim në Kuvendin e Komunës i cili duhet të votohet. Me shumë keqardhje po e them, por unë e shoh një dobësi menaxheriale në këtë pikë nga ana e Kryesuesit

të Kuvendit, dhe si pasoj e kësaj po dalim qesharak ku pothuajse në çdo seancë po duhet të propozojmë pika ose emra të këshilltarëve, andaj të sugjeroj që ju Kryesues i Kuvendit të merreni me këtë çështje konform dispozitave ligjore.

z.Haki Rudari, theksoi, lidhur me këtë temë, shumë mirë e tha kolegu nga Grupi i LVV-së, por ajo që unë desha të them është se në rast se propozimi në fjalë hedhet në votim, e që mendoj se është kërkesë e drejtë e kolegut nga radhët e PDK-së, atëherë nuk kemi se për çfarë të ulemi – takohemi pastaj ne shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit për këtë çështje, mirëpo propozoj që të takohemi dhe prezent të jetë edhe Kryesuesi i Kuvendit, ta gjejmë një modus. Jemi në dijeni se PDK-ja nuk është e përfaqësuar në Komitete dhe Komisione në bazë të përqindjes që e ka, andaj mendoj se do të ishte shumë më mirë që në nivel të shefave të Grupeve të Këshilltarëve të gjejmë mënyrën se si të bëjmë zëvendësimet, propozimet ose përmirësimet konform rregullave, përndryshe në rast se sot hedhet në votim dhe ky propozim nuk kalon, unë si shef i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së nuk do të marrë pjesë në takimin e mundshëm të shefave të Grupeve. Vlen të theksohet se për këtë çështje kemi pasur takime te Kryesuesi i Kuvendit, LVV është e gatshme të merre pjesë aty ku është interesi i të gjithëve.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim, unë do të mundohem të nxjerrë një konkluzion nga kjo që u debatua deri tani rreth propozimit të shefit të këshilltarëve të PDK-së për përfaqësim në Komitete dhe Komisione të Kuvendit të Komunës. Jemi në dijeni se z.Rafet Llapashtica ka kohë që e ka ngritë këtë çështje, pastaj jemi takuar dy herë, shefat e Grupeve dhe unë, me përjashtim të shefit të Grupit nga radhët e PDK-së i cili nuk ka marrë pjesë, andaj si pasoj e mos prezencës së tij nuk kemi mundur të arrijmë një marrëveshje. *(diskutime mes z.Rafet Llapashtica dhe Kryesuesit të Kuvendit)*

Kryesuesi i Kuvendit në vazhdim shtoi, ne kemi një Rregullore të Punës së Kuvendit të cilës duhet t'i përmbahemi, e jo të veprojmë në kundërshtim me atë siç është rasti që z.Rafet Llapashtica i cili merr fjalën dhe del në foltore pa lejen e Kryesuesit të Kuvendit edhe përkundër që vetëm rreth rendit të ditës ka marrë fjalën tri herë.

Unë mund ta hedh në votim propozimin e juaj, por nuk është i qëndrueshëm, mirëpo konsideroj dhe e përkrahi propozimin e dytë që e përkrahën edhe Grupet e këshilltarëve nga radhët e LDK-së dhe LVV-së, andaj nëse pajtoheni unë nuk e hedh në votim, por propozoj që të mbahet një takim mes shefave të Grupeve ku do të jem prezent dhe unë si Kryesues i Kuvendit, takimi të caktohet në ditën kur do të mbahet mbledhja e radhës e KPF-së, para mbledhjes.

Pas diskutimeve, këshilltarët e Kuvendit njëzëri pajtohen me propozimin e Kryesuesit të Kuvendit që takimi mes Kryesuesit të Kuvendit dhe shefave të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit të mbahet në ditën kur do të mbahet mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht para asaj mbledhje

Kryesuesi i Kuvendit, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimi konstatohet se njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës më 06 dhjetor 2016

Pas votimi u konstatua se njëzëri miratohet Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës më 06 dhjetor 2016

3. Propozimi i Planit të integritetit

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë propozim Plan, mirëpo kërkohet që edhe në këtë mbledhje të paraqitet një fjalë hyrëse të cilën do ta paraqesë drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ky Plan është një dokument strategjik dhe operativ i cili ka dal nga procesi i vlerësimit të rrezikut të realizuar në kuadër të Komunës së Podujevës dhe i cili rithekson përkushtimin e Komunës për të shtuar edhe më tej kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet e kryera, me fokus në ofrimin e shërbimeve transparente dhe efikase me klientin në qendër. Gjithashtu në këtë dokument përshkruhen masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të saja të integritetit dhe forcimin e sundimit të ligjit si dhe vlera dhe standarde profesionale, i cili po ashtu do të luaj rol shumë të rëndësishëm për Komunën e Podujevës sa i përket parashikimit të menaxhimit të rrezikut të integritetit për tërë Organizatën me fokus strategjik në fushat me rrezik të lartë, balancimin e menaxhimit të rrezikut të integritetit pro aktiv, në menaxhimin reaktiv, eliminimin e mundësive për korrupsion dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme ndaj korrupsionit, forcimin e respektimit të kërkesave përkatëse ligjore dhe procedurale si dhe standardeve ndërkombëtare të menaxhimit, zhvillimin e mëtejme të kapaciteteve të të gjithë stafit për parandalimin dhe zbulimin efektiv të cenueshmërisë së integritetit, ndërgjegjësimin e tyre në të gjitha nivelet dhe funksionet, inkurajimin dhe përkushtimin kolektiv si dhe bashkëpronësisë në menaxhimin e integritetit, forcimin e mirëbesimit me akterët e jashtëm dhe të brendshëm dhe reagimi ndaj kërkesave dhe pritjeve për sa i përket performancës së integritetit të Komunës.

Plani ndërtohet mbi bazat e rezultateve të një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të rrezikut, i cili është realizuar në Komunën e Podujevës që është iniciuar në fillim të vitit 2016, Plan i cili konsiderohet të jetë pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme të planifikimit komunal lidhur me planin strategjik për zhvillimin institucional i cili prek edhe aspektet e menaxhimit të rrezikut në nivel edhe më të gjerë ku ai plotëson zbatimin më efektiv të planit të veprimit kundër korrupsionit në pjesën që ka të bëjë me qeverisjen lokale. Me zbatimin e këtij propozim Plani, Komuna e Podujevës do të jetë në një pozitë më të mirë në sigurimin e efikasitetet, efektivitetit, transparencës dhe etikës. Rreziqet e identifikuar në nivel të përgjithshëm të cenueshmërisë së integritetit të Komunës ku në një kapitull janë rreziqet e identifikuar dhe shkalla e përgjithshme e rrezikshmërisë së integritetit të Komunës ku rreziqet janë të ndara në dy grupe të përbëra prej 14 fushave të rrezikut të cilat mund t'i gjeni në dokument (*në vazhdim drejtori lexon të 14 fushat përkatëse*). Për fund falënderoj grupin punues i cili ka përgatitur këtë Plan shumë të mirë për Komunën e Podujevës për periudhën e ardhshme trevjeçare.

z.Fidan Rekalju, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim Plani të Integritetit për Komunën e Podujevës. Sa i përket rëndësisë së këtij dokumenti sqarimet dhe arsyetimet e nevojshme i bëri shumë mirë parafolësi – drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, andaj në këtë aspekt edhe ne mendojmë se është Plan i një rëndësie të veçantë për Komunën e Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dje në mbledhjen e KPF-së, drejtori i DBF z.Isuf Latifi na njoftoj se janë plotësuar formular nga ana e zyrtarëve komunal në mënyrë anonime dhe pa emra për gjendjen reale, dhe nga kjo gjendje UNDP së bashku me grupin punues kanë nxjerrë këtë Plan të integritetit duke u bazuar në gjendjen reale të mbushjes së formularëve nga zyrtarët administrativ dhe personeli i Komunës. UNDP bashkërisht me Ekzekutivin e Komunës dhe Grupet punuese

gjatë hartimit të këtij Plani kanë paraqitur një gjendje reale e cila është jo e kënaqshme në Komunën e Podujevës duke përfshirë të gjitha fushat e paraqitura në këtë dokument.

Përshtypje në këtë dokument më kanë bërë disa fusha të cilat janë elementare dhe të cilat nuk do ta kishin lejuar Ekzekutivin e Komunës të rrëshqas drejt keq qeverisjes ku një prej pikave më të rëndësishme është se rekrutimi i kandidatëve nuk është efikas e që jep një performacë reale në administratën komunale, pastaj kemi problemin tjetër ku nuk janë të gjithë zyrtarët e auditimit të brendshëm të kualifikuar ashtu siç kërkohet me ligj, në mënyrë që të mund të bëjnë një auditim të brendshëm dhe të paraqesin gjendjen reale dhe ta këshillojnë Kryetarin e Komunës për çështje të ndryshme të cilat nuk janë në nivel, para se auditimi të bëhet nga auditori i jashtëm.

Pastaj kemi fusha tjera siç është rasti në arsim ku rekrutimi i personelit është i paefektshëm e që nuk zbatohen tri fusha kryesore që janë organizimi, punonjësit dhe procesi i përzgjedhjes ku edhe janë dhënë rekomandime shumë të qarta dhe konkrete rreth kësaj çështjeje si; shtrëngimi i proceseve të rekrutimit për personelin arsimor, rritja e kontroleve ndaj diplomave false apo ndaj personave të padiplomuar të cilën konkurrojnë për mësimdhënës në shkollat e Komunës së Podujevës e që kemi pasur mjaft raste që ka pasur profesorë të pa diplomuar apo që në shumë shkolla në vendet rurale ende ligjërojnë profesor me shkolla të mesme, çështje për të cilën do të dëshiroja që viti 2016 të jetë viti i fundit që në shkolla e Komunës së Podujevës ligjërojnë mësimdhënës me shkollë e mesme, kurse në anën tjetër nga ana e Ekzekutivit të Komunës të injorohen kuadro të reja me kualifikime përkatëse, për probleme politike. Problem tjetër në këtë dokument është edhe kadastrri dhe gjeodezia, ne disa herë kemi ngritur problemin e pronave publike në territorin e Komunës së Podujevës, mirëpo Drejtoria përkatëse nuk ka ndërmarrë hapa, por si do që të jetë nuk do të dëshiroja që gjendja reale të jetë ashtu siç paraqitet në këtë propozim Plan ku thuhet se mungojnë shënime kadastrale, gjë e cila më bënë t'i besoj plotësisht këtij dokumenti sepse ne kemi kërkuar një gjendje kadastrale të pronave publike dhe vërtetë nuk ka pas të dhëna dhe nuk na janë sjellë me dokument, pra është hera e gjashtë kjo që po e potencoj se ne kemi kërkuar listën e pronave publike sidomos në qytet, mirëpo aty shihet se mungojnë të dhënat dhe regjistrimet kadastrale në zyrën e kadastrit në Komunën e Podujevës, përkatësisht në atë listë nuk figuron apo ndoshta nuk na është sjellë prona publike prej 2 hektarëve përball hotel Besianës, ku tani zhvillohet një biznes privat në atë pronë, pastaj nuk janë sjellë pikat kyçe të pronave publike në Podujevë të cilat ne jemi në dijeni se janë të rëndësishme së veçantë, por më shumë ka qenë një listë e pronave publike ku janë përfshirë ato në zonat rurale e që një pjesë e madhe e tyre janë të uzurpuara nga fshatarët por që nuk kanë një kosto të lartë sikurse ato të qytetit, prandaj nuk jam në dijeni i nderuari drejtor z.Abaz Llugaliu, a nuk e keni sjellë me qëllim pronën e cekur përball hotel Besianës apo ndoshta është duke u keqpërdorur ajo pronë, a mos keni pasur ndonjë presion që të mos sjellët ajo pronë apo cila është arsyeja e mos sjelljes së të dhënave kadastrale të pronave publike në qytet. E thash që plotësisht i besoj këtij dokumenti që pronat nuk janë të regjistruara, ne kemi të dhëna, por mbetet që ta vërtetojmë se drejtori përkatës bënë tjetërsim të pronës publike e që barra kryesore në fund të fundit do të bie në drejtorin z.Abaz Llugaliu me arsyen se ky duhet ta mbroj dikë tjetër.

Dëshiroj që në vitin 2017 të gjitha këto propozime të dhëna në këtë propozim Plan të integrohen në Komunën e Podujevës, po ashtu do të dëshiroja që të gjitha këto çështje të jenë në rregull dhe pa vërejtje në mënyrë që mos të diskutoja fare në këtë sallë, sepse ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit është ftohtë e që mendoj se është faji i vetë Kryesuesit që asnjëherë nuk ka ndërmarr asnjë hap për të rregulluar sado pak problemin e nxemjes në këtë sallë dhe për krijimin e kushteve më të mira për punë. Pa dashur të zgjati më shumë, besoj se dokumentin përkatës të

gjithë e posedoni dhe se për gjendjen reale në administratën komunale dhe Ekzekutivin e Komunës të gjithë jeni në dijeni dhe secili mund të vlerësoj nga këndi i tij.

z.Haki Rudari, theksoi, Planin e integritetit 2016-2019 për Komunën e Podujevës si një dokument të veçantë natyrisht se ne Grupi i LVV-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar, çështjet që ne i kemi gjetur vërtetë janë lëshime dhe dobësi të shumta. Ky dokument i përbërë prej 3 kapitujve, nga 14 fusha ku secila fusha ka edhe nën fushat e veta e që në total kemi afër 100 fusha të rreziqeve të cilat janë gjetur dhe janë dhënë pikërisht nga punëtorët e Komunës. Në faqen 6 ndër të tjerash thuhet, të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të këtyre fushave dhe të propozojnë masa për përmirësimin, integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit, pra për këtë dokument që ne sot po flasim nuk do të thotë që vetëm po flasim nga këndi i LVV-së, por këtë e kanë dhënë punëtorët e Kuvendit Komunal. Pa dashur të hyj në detaje të këtij dokumenti, për arsye se është 76 fletë, ne kemi gjetur disa fusha të cilat vërtetë meritojnë dhe duhet të lexohen, dhe atë; 1-planet buxhetore nuk janë transparente, e që ne si Grup i LVV-së vazhdimisht kemi dhënë vërejtje, 2-abuzim me përdorimin e automjeteve zyrtare, 3-kapacitete të dobëta për verifikimin dhe regjistrimin e pronës, çështje që ne vazhdimisht e kemi ngritur, 4-rexhistrimi i aseteve nuk ekziston, gjë e cila është edhe në raportin e auditimit, 5-keqpërdorim i orarit të punës, ku në orar të punës dalin dhe bëjnë fushata të ndryshme, 6-trajnimet e ofruara nuk janë në përputhje me nevojat e trajnimeve, 7-funksioni i auditorit është i dobët, 8-jo të gjithë auditorët janë të licencuar në bazë të ligjit në fuqi, 9-auditorët e brendshëm kanë mungesë të trajnimit profesional, 10-rekrutimi ose përzgjedhja e personelit të arsimit është i paefektshëm ose jo i mirë, çështje që po ashtu ne i kemi ngritur disa herë, 11-kontrollet mbi institucionet private jo efikase, 12-ndarja e subvencioneve ose ndihmave nuk është efikase apo bëhet pa kriter, 13-ka dëshmi të bizneseve jo formale, çështje e cila është shumë serioze dhe është përgjegjësi e Drejtorisë së Inspeksionit dhe qeverisë komunale, 14-menaxhimi i pyjeve si aset kyç nuk është efikas, 15-mungesë e fushatave për mbrojtjen e pyjeve, 16-mungesë e koordinimit me donator të mundshëm, bizneset dhe shoqërinë civile, gjë e cila është mjaft e rëndësishme, 17-funksioni i kadastrit nuk është efikas dhe mungojnë kontrollet, 18-fondi i ulët i subvencioneve për ndihma sociale, 19-kriter i përdorur për ndarjen e subvencioneve jo transparente, çështje që po ashtu ne e kemi ngritur dhe në një formë janë pajtuar edhe anëtarët e pozitës se subvencionet nuk jepen sipas kriterëve por vetëm në bazë të ndonjë afërsie çfarëdo qoftë ajo, 20-nuk ka politikë të mirëfilltë për trajtimin e ujërave të zeza, 21-nuk ka strategji komunale për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, 22-mungesë e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e antikorrupsionit dhe 23-mungesë e planit të punës nga ana e Drejtorive për vitet vijuese. Prandaj mendoj se të gjitha këto të gjetura tregojnë se kemi të bëjmë me një Plan të integritetit 2016-2019 jo të mirë i cili natyrisht se duhet të përmirësohet dhe krejt këto çka i cekta janë të gjetura në këtë dokument, nëse dëshironi ne mund të hymë edhe më në detaje, por të gjitha këto por edhe çështje tjera janë të evidentuara nga ky raport.

z.Kadri Avdiu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve G-Plus që aktualisht përbëhemi prej tre anëtarëve por që nga seanca e ardhshme presim të na shtohen edhe dy anëtarë tjerë, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar rreth propozim Planit të integritetit për të cilin mendoj se ky është vetëm një propozim Plan e jo ashtu siç u quajt draft dokument e ku ta di unë, ashtu e kuptoj unë sepse ashtu edhe është i shkruar dhe s'ka si të thuhet ndryshe dhe nuk mund ta them ndryshe, pra në mbledhjen e KPF-së i kemi dhënë një mbështetje këtij propozim Plani që i njëjti të kaloj, andaj edhe sot i japim mbështetje.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, mora fjalën me qëllim që të jap disa sqarime rreth këtij propozim Plani ngase në bazë të asaj që dëgjova deri tani nga disa këshilltarë po del se e gjithë puna që është bërë për 1 vit në përgatitjen e këtij propozim Plani është keqkuptuar shumë. Ky propozim nuk është raport, këto nuk janë të gjetura, nuk është dokument i hartuar nga UNDP-ja, por është një dokument i përgatitur dhe i hartuar nga Grupi punues i ngritur nga Kryetari i Komunës e që unë kam qenë koordinator i Grupit, mbështetja financiare ka qenë nga UNDP-ja dhe roli i kësaj organizate ka qenë të na ndihmoj në metodologjinë e punës dhe mbulimin e shpenzimeve të punëtorëve që kemi mbajtur nëpër vende të ndryshme.

Propozim Plani ka për qëllim mbrojtjen prej rreziqeve të mundshme të cilat ne i kemi identifikuar si rreziqe për të ardhmen. Nuk është Plan të cilin e kanë bërë punëtorët e Komunës ashtu siç u cek deri tani nga disa parafolës, edhe pse në çdo përgatitje të planeve të ndryshme bëhen pyetësorët dhe merren edhe mendimet e punëtorëve. Ky është një Plan i cili për vitet 2017-2019 do ta mbroj secilin Institucion komunal dhe secilin zyrtar, nga korrupsioni i mundshëm, nga shkeljet e detyrave të punës, nga keqpërdorimet e mundshme të cilat ne si Grup punues i kemi imagjinuar si të mundshme. Normal që ne i kemi pyetur punëtorët komunal se çka mendoni ju që në punën e juaj ditore është kërcënim apo rrezik, shembull, u përmend për Drejtorinë e Arsimit rekrutimi i stafit, ne kemi pyetur drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, çka mendoni se është sfidë për Drejtorinë e Arsimit, përgjigja ka qenë që sfidë ende mbetet rekrutimi i stafit, dhe ne e kemi evidentuar si kërcënim ose rrezik për të cilin në të ardhmen duhet të punojmë ta shmangim. Pra kjo është e gjithë filozofia e këtij propozim Plani, e përsëris se nuk është raport dhe nuk e ka hartuar askush dhe nuk janë të gjetura, por janë rreziqe që ne si Grup punues i kemi evidentuar dhe kemi paraparë se si t'i shmangim ato që mos të ndodhin.

Ne si Grup punues që kemi punuar për një vit mendojmë që përkushtimi dhe angazhimi jonë për hartimin e këtij Plani ka qenë shumë i madh, gjë e cila është vlerësuar maksimalisht edhe nga UNDP-ja. Besoj shumë se është në interesin e të gjithëve që ky propozim Plan të mbështetet në mënyrë që të gjithë zyrtarët e Komunës së Podujevës ta kenë përpara një listë të rreziqeve të cilave duhet t'ju shmangen gjatë kryerjes së obligimeve dhe përgjegjësisë të tyre.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj shumë Nënkryetarin e Komunës për sqarimet e dhëna, gjithashtu falënderoj edhe Grupin Punues për përgatitjen dhe hartimin e këtij propozim Plani për të cilin tani konsideroj se është shumë i qartë. Andaj meqë nuk këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim rreth kësaj pike, e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, Kuvendi i Komunës vendosi për miratimin e propozim Planit të Integritetit 2016 – 2019 në Komunën e Podujevës.

4. Propozimi i Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2017 – 2022

- Vendimi për vënie në diskutim publik

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni draft Planin lokal për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2017 - 2022 para se i njëjti të vëhet në diskutim publik. Komuna e Podujevës së bashku me 17 Komuna të Republikës së Kosovës ka qenë përfutuese e donacionit nga Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtarë, Organizata GIZ, Ministra e Mjedisit

dhe Planifikimit Hapësinorë si dhe Kompania "Eko Dizajn" të cilët kanë punuar në bashkëpunim me Ekipet punuese të Komunave, për çka i falënderoj të gjithë për kontributet e tyre në hartimin e një dokumenti të tillë. Në fillim të draftit përkatës gjithashtu është paraqitur mbështetja ligjore. Dokumenti është bukur voluminoz dhe i cili parasheh të gjitha aspektet sa përket menaxhimit të mbeturinave. Shpresoj që ky Draft do të përpunohet nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës por edhe nga qytetarët në përgjithësi dhe mirëpres vërejtje, sugjerime dhe propozime të ndryshme në mënyrë që Plani final të jetë sa më i kompletuar. Ne në mbledhjen e KPF-së jemi përcaktuar që diskutimi publik të zgjat deri më 20 janar 2017 ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 18 janar 2017 duke filluar nga ora 13:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

Nuk dëshiroj të ndalem më shumë rreth këtij propozim Plani, por e theksoj që me këtë mundësohet përmbledhja e çështjeve mjaft të rëndësishme sa i përket aspektit të menaxhimit të mbeturinave. Pra konsideroj se Drafti në fjalë ende ka nevojë të pasurohet për nga aspekti i lektyrimit dhe aspekte tjera teknike, por shpresoj që në debatin publik do të jepen të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe plotësim-ndryshimet e nevojshme, ku ne si Ekip do t'i mbledhim, do t'i shqyrtojmë, analizojmë dhe në fund do t'i procedojmë sërish në Kuvend për shqyrtim dhe miratim në Planin final.

Vlen të theksohet se drafti i Planit ndoshta pak sa është edhe ambicioz ngase parashihet mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave siç janë ato medicinale, të vajrave të llojllojshme e të tjera, por që domosdoshmërisht edhe Komuna e Podujevës në një të ardhme të afërt duhet të filloj të merret edhe me ato mbeturina, prandaj edhe duhet të parashihen.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ky draft dokument nga sot deri më 20 janar 2017, nëse miratohet ashtu, do të jetë në diskutim publik ku të gjithë këshilltarët e Kuvendit por edhe qytetarët mund ta shqyrtojnë, analizojnë dhe përpunojnë ku pastaj të gjitha propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet mund të jepen në formë të shkruar gjatë kësaj periudhe por edhe në debatin publik që do të mbahet më 18 janar 2017, andaj meqë ekzistojnë këto mundësi është mirë t'i shfrytëzojmë dhe të japim kontributet tona secili prej nesh.

z.Flakron Gashi, theksoi, nuk është e lehtë që rreth 80 faqe material sa ka ky propozim Plan të kalohen për pak minuta, nëse unë kaloj 10 minutshin mos ma shihni për të madhe, dhe në këtë aspekt i nderuari Kryesues kërkoj nga ju dhe të sugjeroj që në mbledhjet e ardhshme t'i racionalizosh pikat e rendit të ditës, për këtë bazohem se vetëm për këtë mbledhje kanë qenë mbi 300 faqe material gjë që është e pamundur për një asamblist të përgatitet si duhet, pra nuk dëshiroj të fajësoj askënd rreth kësaj por kërkoj që në mbledhjet e ardhshme të jeni më korrekt. Gjithashtu kushtet për punë në këtë sallë nuk janë të mira e sidomos në këto ditë të ftohta, unë mendoj se ky është institucion dhe ju si Kryesues i Kuvendit duhet t'i rrini gati.

Para se të filloj të diskutoj, nuk e di se janë të ftuar dy përfaqësuesit e dy kompanive; asaj "Pastrimi" dhe "Natyra", por si duket nga Kompania "Pastrimi" nuk qenka askush dhe këtu shihet serioziteti i punës dhe trajtimi i kësaj pike të veçantë të ditës.

Plani si i tillë ka pasqyruar drejtë gjendjen reale dhe demografike të Komunës së Podujevës, duke përfshirë, njësitë, amvisëritë, numrin e Kompanive që operojnë, nevojën dhe pritshmërinë, kostot e operimit, organogramin e funksionimit dhe trajtimit të mbeturinave, si dhe objektivat dhe specifikacionet e tjera që autoritetet lokale duhet të ndërmarrin sipas Planit të veprimit, me fillim vitin 2017 deri në vitin 2019, një kohëzgjatje plot 3 vite, por në këtë plan ka shpërputhje në shifra, dhe një pjesë këtyre masave ka pasë mundësi të ndërmerren më herët. Nga drejtori parafolës, të gjitha u thanë, por një çështje u anashkalua, me apo pa qëllim nuk e di. Ky Plan për bazë ligjore ka ligjin për menaxhimin e mbeturinave, i cili është aprovuar në qershor të vitit 2012, fiks 4 vite e 5 muaj më herët, nëse si pikë referimi marrim ditën e sodit. Bazuar në këtë ligj, Komuna është përgjegjëse për marrjen e shumë veprimeve të cilat ka pasur mundësi t'i marrë shumë më herët,

por që nuk ka marrë asnjëherë. Komuna fillimisht e vë në pah se cilësia e shërbimit të ofruar nga të dy Kompanitë nuk është në standardin e kërkuar, si pasojë e mos kontrollit dhe monitorimit rigoroz, dhe më tej e pranon se ka dështuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe burimeve financiare. A mendon se me krijimin e një pozite të re të ashtuquajtur "zyrtari i mbeturinave" mund të realizoni këtë plan, unë dyshoj, madje edhe emërimi i atij zyrtari ose asaj pozite duhet të jetë më adekuat. Sipas këtyre mangësive dhe papërgjegjësisë, Komuna e Podujevës e ka humbur hapin në trajtimin e mbeturinave, dhe sot kur po debatojmë, lumi Llap më shumë i ngjan një lumi të vdekur nëpër të cilin më shumë rrjedhin mbeturina se sa ujë dhe peshq, dhe hapësirat e gjelbëruara janë shndërruar në deponi mbeturinash. Nëse Komuna në Planin e saj e pranon vetë se janë të evidentuara mbi 40 deponi të egra, deponi tjera të mbetjeve të hekurit dhe baterive, madje të gjitha këto ilegale, nuk është e justifikueshme arsyetimi i mungesës financiare dhe resurseve njerëzore, por është karakteristikë tipike e një qeverisje të papërgjegjshme për çështje mjedisore. Sipas këtij Plani dhe të dhënave që disponojnë Kompanitë në fjalë nga gjithsejtë 78 njësi ose fshatra që ka Komuna e Podujevës, shërbimi ofrohet apo shtrihet në 51 njësi ose fshatra, por e meta e kësaj është se vetëm 49% e amvisërive në Komunën e Podujevës mbulohen me shërbimin e mbeturinave, ndërsa për vitet që vijnë parashihet trend i rritjes së gjenerimit të mbeturinave. Sipas analizave të këtij Plani, Kompania KRM "Pastrimi", për vitet 2013, 2014, 2015, deri në tetor të vitit 2016 ka grumbulluar rreth 19,780 ton mbeturina, ndërsa gjatë këtyre viteve janë gjeneruar kryesisht nga amvisëritë mbi 35,000 ton, kurse nga ato inerte mbi 9,700 ton. Për ta rrumbullakuar dhe sqaruar për ju dhe qytetarët, më shumë se 65% e mbeturinave të gjeneruara ndër vite gjenden në natyrë, e me gjuhë më të kapshme do të thotë se miliona e miliona kg. mbeturina, të cilat ndoshta çdo ditë po na vrasin në heshtje. Kush dyshon në këtë shikoni statistikën dhe llojet e sëmundjeve të cilat çdo ditë po marrin jetë.

Nëse i referohemi gjendjes së deponisë qendrore në Dumnice e cila nuk plotëson standardet, siç është mos klasifikimi i mbeturinave, rrjedhja e ujit etj. cili është roli juaj si Komunë dhe çfarë masash keni ndërmarrë deri tash, pavarësisht se me këtë deponi administron një organ shtetëror, mos harroni se deponia është në territorin e Komunës së Podujevës dhe unë mendoj që si organe komunale duhet të ndërmerren masa përveç shënimeve në letër. Pastaj pika tjetër paraqitet si problem i operimit të Kompanive dhe çështje e inkasimit kundrejt pritjeve të faturimit, ku ndër të tjera si arsye e ulët e inkasimit paraqiten për këto arsye, a)-nuk janë të vetëdijshëm, dhe b)-nuk mund ta përballojnë. Sipas meje këto arsye janë utopike, kushdo që e ka bërë këtë Plan sepse ata që nuk paguajnë ose që nuk dëshirojnë fare të kyçen në këto shërbime janë shumë të vetëdijshëm, sipas mendimit tim, por e kanë vërejtur mungesën e seriozitetit të organeve komunale dhe mos trajtimi i tyre nga aspekti ligjor. Ne jemi në dijeni se buxheti për vitin që vjen është aprovuar, ndërsa në këtë Plan tek pjesa operacionale shihet një shumë me të cilën ngarkohet Komuna (të paktën nuk ka specifikacion të saktë), vlera e së cilës është mbi 661,640.00 €, ku pjesa më e madhe në vlerë 538,455.00 € aludohet në pika, a)-analizimi i mundësive dhe mjeteve financiare të nevojshme që i nevojiten Kompanisë për të zgjeruar shërbimin, e që ka të bëjë me furnizimin nga ana e Komunës me 13,455 shporta, ndërsa në fillim ceket se përgjegjësia e Kompanive është furnizimi me shporta. Nuk mendoj se furnizimi me shporta e rritë dhe pjesëmarrjen e amvisërive për ta pranuar këtë shërbim, madje jam shumë i bindur që edhe ata që tani janë të kyçur në këtë shërbim nuk përdorin fare shporta, andaj mendoj që të ngarkohet Komuna për një periudhë 3 vjeçare me mbi gjysmë milioni euro për të furnizuar amvisëritë me shporta, e që në fakt është obligim i Kompanive, nuk është në rregull. I nderuari drejtor, mund të mos pajtohesh, por ashtu është në plan. Kur e thashë më herët se ky plan ka shpërputhje të mëdha të shifrave, ju mbeta borxh, dëgjoni me vëmendje, shtrohet pyetja, nëse në deponinë

qendrore të mbeturinave në Dumnicë, sipas këtij plani depozitohen rreth 850 ton mbetje në muaj të Komunës së Podujevës, për vitet që ju keni referuar nga 2013 gjer në vitin 2016 del që depozitohen rreth 39,900 ton mbetje, pra më shumë deponohen se sa që gjenerohen, dhe sipas kësaj logjike, qysh është e mundur të ndotet deri në këtë masë Podujeva kur më shumë depozitohen mbeturina se sa që gjenerohen.

Ndërsa për fund, është e rrugës që ky propozim të dal në diskutim publik, por të punohet që ky diskutim të jetë më serioz, e jo me pjesëmarrjen e 6 apo 7 qytetarëve, dhe jo të mbahet vetëm në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, por të parashihen më shumë takime dhe debati të kaloj edhe në fshatra dhe bashkësi.

z.Bahri Selimi, theksoi, duke u bazuar në gjendjen e mbeturinave që është në Komunën e Podujevës, vërtetë kem shumë çfarë të flasim për këtë plan i cili në shikim të parë mendoj se është i përmbledhur shumë mirë ashtu siç edhe parafolësi e ceku se plani paraqet gjendjen reale të mbeturinave në Komunën e Podujevës. Meqë plani do të del në diskutim publik ne nuk do të zgjatim shumë sepse vërejtjet dhe arsyet e vërejtjeve, mangësitë dhe plotësimet mendoj se do t'i plotësojmë deri atëherë, gjithëherë duke qenë skeptik në debatet të cilat mbahen në Komunën e Podujevës. Mendoj se debatet publike janë shumë të vobekta dhe të mangëta ku pjesëmarrja e qytetarëve në këto debate, nuk e di me fajin e kujt, por është shumë e ulët, prandaj nuk e di se sa mund të thirremi në debate qytetare përderisa shumë herë që unë kam marrë pjesë në debate të tilla në këtë sallë, vetëm sa për kureshtje për ta parë pjesëmarrjen e qytetarëve, kamë parë se numri i pjesëmarrjes ka qenë shumë i ulët. Mendoj se gjëja e parë që ne duhet të bëjmë është që ne të mundohemi që t'i nxisim sa më shumë qytetarë që të jenë pjesëmarrës në debate të tilla, jo vetëm sa i përket menaxhimit të mbeturinave, por edhe në debate tjera siç është, projektimi i buxhetit, korniza afatmesme që është projekt shumë më i rëndësishëm etj. Andaj për të mos u zgjeruar më në detaje, ne më shumë kontributin tonë do ta japim deri në miratimin final të këtij dokumenti, ne si këshilltarë të Kuvendit duke përfshirë edhe stafin komunal, që do të ishte më mirë se sa që t'ia lëmë këtë punë debatit me qytetarë. Ajo që unë mendoj se është shumë e rëndësishme si pikë, ka të bëjë tek klasifikimi i mbeturinave, Komuna e Podujevës ka të miratuar një Rregullore e cila parasheh shumë mirë dhe qartë klasifikimin e mbeturinave, por nuk e di se a ka pasë ndonjëherë klasifikim të mbeturinave në Komunën e Podujevës nga dy Kompanitë të cilat merren me grumbullimin e mbeturinave, gjë për të cilën dyshoj sepse përderisa ne dhe qytetarët e Komunës së Podujevës nuk shohim kontejnerët e ndarë me ngjyra të ndryshme dhe me mbishkrime për hudhjen e mbeturinave, nuk mendoj se ka ndonjë klasifikim të mirëfilltë, dhe për këtë bazohem duke marrë parasysh se përderisa hudhen letra dhe hekur njëkohësisht në një kontejnerë, ai nuk është klasifikim, mirëpo ajo çka unë dua të them është se ne duhet të bazohemi në Rregulloren nr.02/2013 e cila e sqaron shumë qartë edhe klasifikimin e mbeturinave, çështje për të cilën mendoj se është mirë dhe duhet të ndodh. Gjithashtu pikë tjetër për të cilën mendoj se duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë si në debat publik me qytetarë ashtu edhe përderisa të mbahet ai debat, është mbulueshmëria e territorit të Komunës së Podujevës nga menaxhimi i mjeteve, sa unë kam vërejtur në këtë Plan janë rreth 23 fshatra që nuk mbulojnë fare, të cilat janë në viset rurale kryesisht në pjesë periferike të territorit të Komunës së Podujevës, mirëpo si do që të jetë edhe në ato fshatra krijohen mbeturina dhe ato sigurisht se hedhen ndokund, prandaj mendoj se duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje dhe kujdes edhe mbulimit të atyre fshatrave nga ana e Kompanive të cilat tash më janë në funksion të qytetarëve. Pastaj në Plan janë cekur 4-5 fshatra të cilat janë vetëm 10% të mbuluara, përqindje për të cilën mendoj se është vetëm sa për të mos thënë që nuk janë fare të mbuluara në rrjetin e menaxhimit të mbeturinave, shembull, fshati Batllavë është i mbuluar vetëm 10%, i bie që vetëm rreth 10 shtëpi paguajnë për mbledhjen

e mbeturinave dhe që janë nën menaxhimin e Kompanive, mandej 11% deri në 30% një numër i madh i fshatrave të cilat janë të mbuluara, kështu që thënë shkurtë, fshatrat të cilat kanë mbulueshmëri të plotë sa i përket menaxhimit të mbeturinave, janë shumë pak, përjashtoj qytetin që i cili ka një mbulueshmëri më të madhe. Pra këto dy pika që i cekta, klasifikimi i mbeturinave, dhe mbulueshmëria e fshatrave ose i tërë territorit, duhet t'i kushtohet rëndësi edhe nga ne këshilltarët e Kuvendit ngase pjesëmarrje qytetarëve në debate është e vogël, madje duke marrë pjesë gjithëherë të njëjtit janë bërë edhe të njofshëm.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth mbeturinave dhe menaxhimit të tyre secili prej nesh kem shumë çka të flasim, dhe është e vërtetë se gjendjen nuk e kemi të mirë në këtë aspekt, madje duhet të nisemi nga vetvetja, a paguajmë apo jo shërbimin e mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave ose që kontribuojmë vetë në këtë drejtim dhe pastaj të ndikojmë në mjedise të ndryshme aty ku mundemi. Sa i përket diskutimit publik dhe debatit publik me qytetarë, ne gjithëherë i kemi respektuar procedurat përkatëse, njoftimet bëhen me kohë, gjithashtu edhe publikimet bëhen me kohë në faqet zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve e cila gjendet në hyrje të këtij objekti si dhe në forma tjera. Nëse pajtoheni me propozimin e drejtorit të DSHPMSh për kohëzgjatjen e diskutimit publik, datën dhe orën e mbajtjes së debatit publik me qytetarë, unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet propozimi i vendimit për vënje në diskutim publik të propozim Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2017 – 2022, përkatësisht që diskutimi publik të zgjat deri më 20 janar 2017, ndërsa debati publik të mbahet më 18 janar 2017 duke filluar nga ora 13;00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

5. Propozimi i Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimt Rinor Lokal në Komunën e Podujevës

- Raporti për zbatimin e diskutimit publik

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se të gjithë jeni në dijeni se ky propozim ka qenë në një prej mbledhjeve të kaluara me që rast është vënë në diskutim publik i cili edhe është mbajtur. Gjithashtu bashkëngjitur me material ju është dërguar edhe raporti i zbatimit të diskutimit publik, po ashtu edhe në mbledhjen e KPF-së i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të kësaj propozim Rregulloreje, mirëpo mendoj se është mirë që fjalën t'ia jap drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtori e cila ka qenë përgjegjëse për mbajtjen e diskutimit dhe debatit publik, andaj edhe paraqitet nevoja për një fjalë hyrëse dhe sqarime të nevojshme rreth kësaj çështjeje.

znj.Mrika Thaqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (DKRS), theksoi, unë nuk dëshiroj të zgjas shumë rreth kësaj çështjeje por fjalën do t'jua kaloj juve këshilltarëve të Kuvendit duke besuar në kontributet e juaja që do të japni për propozim Rregulloren në fjalë duke qenë në dijeni për rëndësinë e saj.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim Rregullore dhe konsiderojmë se është një aktet më të rëndësishme të Komunës së Podujevës për të rinjtë e Komunës së Podujevës. Njëkohësisht ne si Grup nga radhët e LDK-së shprehim gatishmërinë tonë që këtë Këshill ta përkrahim edhe në aspektin financiarë duke qenë në dijeni për rëndësinë e veçantë që ka ky Këshill për interesin e të rinjve të Komunës së Podujevës, si dhe do t'i përkrahim vazhdimisht të rinjtë e Komunës tonë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne e kemi mbështetur këtë propozim përkatësisht themelimin e këtij organi ekzistues. Gjithashtu të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit jemi pajtuar që ky Këshill të jetë rinorë, komunal dhe jopolitik, ngase siç jemi në dijeni të gjitha subjektet politike kemi rini dhe në një formë mund t'i infiltrojmë në atë Këshill në mënyrën më të keqe, mirëpo nëse mendojmë ne si Kuvend i Komunës që ta krijojmë njëmend një Këshill komunal dhe t'i japim mbështetje institucionale si dhe të ndajmë buxhet për aktivitetet e tyre, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës duke u mbështetur edhe në programin politikë që kemi, mbështesim themelimin e një Këshilli rinorë, si dhe do ta keni mbështetjen tonë pa rezervë edhe në të ardhmen edhe sa i përket pjesëmarrjes. Për sigurimin e buxhetit, mendoj se nga të hyrat vetanake ekziston mundësia që Komuna të ndan mjete të nevojshme për aktivitetet e Këshillit që do të mbikëqyren nga ana e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit ku përgjegjësia e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë bie mbi drejtoreshën. Ne të gjithë jemi në dijeni se të rinjtë mund të manipulohen politikisht ngase partitë politike kanë interesat e tyre partiake, por nuk do të doja që Këshilli në fjalë të jetë i manipuluar politikisht, por vërtetë të themelohet dhe të funksionoj ashtu siç duhet, dhe ta ketë mbështetjen e të gjitha subjekteve politike qoftë për buxhetin qoftë për aktivitetet e tyre. Urojmë që Këshilli ta kryen punën e vet në mënyrën më të mirë ashtu siç i ka hije rinisë së Komunës së Podujevës për arsye se gjithëherë si rini e Podujevës ka dhënë kontributin e vet në çdo aspekt, qoftë kulturorë, institucional, qoftë Kombëtarë.

z.Haki Rudari, theksoi, në parim Lëvizja Vetëvendosje e ka përkrahur këtë propozim Rregullore për themelimin dhe funksionimin e Këshillit rinor lokal, mirëpo gjatë vizitave dhe kontakteve që kemi pasë, rinia kanë vërejtje të shumta. Jemi kundër që rinia të jetë e politizuar apo instrument i politikës zyrtare, mendoj se në këtë drejtim edhe Komuna e Podujevës nuk është imune ndaj kësaj çështje, prandaj vërejtjet që na kanë ardhur ekzistojnë, dhe ne si Grup nga radhët e LVV-së, ndonëse përkrahim Rregulloret dhe ndihmat që i jepen rinisë, por megjithatë jemi kundër kësaj forme që rinia të bëhet instrument i politikës komunale. Gjatë zgjedhjeve të mbajtur nga Forumi i Gruas së LDK-së, kemi pas vërejtje të shumta për arsye se në ato mbledhje kanë marrë pjesë edhe nxënës të shkollës fillore, fjala është për mesin ku unë punoj dhe nga unë vijë, përkatësisht në fshatrat Shajkoc dhe Siboc ku mbledhjet e Forumit të lartcekur janë mbajtur në ora 15:00, nëse dëshironi flasim edhe me emra, dhe në ato mbledhje kanë insistuar dhe kanë marrë pjesë edhe mësime të mësimdhënës, madje pa qenë edhe banorë të atyre fshatrave fare, mirëpo në ora 15:00 është proces mësimorë, ndërsa është dashtë të lirohet klasa për t'iu lëshuar për aktivitet politik, prandaj për këto dhe shumë arsye tjera për të cilat kamë informacione dhe nëse dëshironi mund të hymë edhe në detaje, mendoj se kemi një politizim, çështje për të cilën LVV është kundër, jemi për përkrahje të rinisë, por jemi kundër që qeveria të bëhet instrument i politikës ditore.

z.Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me propozim Rregulloren për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, pa dyshim se nuk kemi për çka të hezitojmë dhe duhet ta mbështetim dhe përkrahim si dhe ndihmojmë atë Këshill qoftë edhe jashtë funksionit që kemi si këshilltarë të Kuvendit të Komunës, ngase po e përsërisë atë që dje në mbledhjen e KPF-së e kam thënë, në përgjithësi me rini nuk kemi punuar sa duhet andaj kemi një obligim më të madh rreth tyre, duhet t'i mbështesim edhe më shumë ngase jo vetëm në Komunën e Podujevës por në nivel vendi gjendjen e kemi jo të mirë sa i përket rinisë. Po ashtu mendoj se në vazhdimësi, në aspektin pozitiv duhet të nxjerrim akte të ndryshme me të cilat rregullohen çështje me rëndësi për rininë tonë, në mënyrë që t'ju krijojmë hapësira të rinjve tanë të merren me aktivitete të ndryshme, të kenë mbështetje institucionale, çështje të cilat mund të ndikojnë që rinia të shmangej nga kafiteritë dhe gjërave tjera me të cilat pothuajse çdo ditë

ballafaqohemi. Prandaj ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit, G-Plus e mbështetim pa rezerva këtë propozim Rregullorë. Sa i përket asaj që u tha se po politizohen të rinjtë, unë e kam thënë dhe po e përsërisë se ne jemi vetë ata të cilët i kemi politizuar fëmijët tanë, secili prej nesh në fushën e vet bënë politikë me fëmijë, ndërsa tani bëhen vërejtje këtu.

z.Flakron Gashi, theksoi, padyshim se kjo propozim Rregullorë do të përkrahet, këtë e tha edhe shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, mirëpo unë nuk pajtohem me atë që parafolësi nga radhët e LDK-së e tha, që ky Këshill të përfaqësoj interesat e të rinjve të Komunës së Podujevës. Jam shumë i bindur dhe këtë e din shumë mirë edhe kolegu që ky Këshill ka përfaqësuar vetëm interesat e të rinjve politik të një partie politike të caktuar, por nuk dëshiroj të flasim më shumë ngase ka emra me pjesëmarrje të ngjashme. Kam dy pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për të cilat kërkoj sqarime; 1-në pikën 2 të raportit nga diskutimi publik që është propozuar thuhet, Njohja e Këshillit të Veprimt Rinor Lokal nga ana e Kryetarit të Komunës përmes një akti (Ekziston shtojca për njehjen e KVRL-së nga Kryetari i Komunës), çka konsiston me këtë njohje nga ana e Kryetarit, a është fjala që këtë çështje e rregullon Ligji dhe Udhëzimi Administrativ përkatës apo çfarë, si dhe 2-në pikën 3 të këtij raporti ku thuhet, propozim përfshirja e Ligjit për lirinë e asociimit në OJQ në kuadër të bazueshmërisë ligjore në draft Rregullorë si dhe përfshirja e parimeve të këtij ligji (parashihet në një nen të Rregullores), për cilin nen të propozim Rregullores është fjala.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, padyshim se kjo propozim Rregullorë është njëra ndër Rregulloret më të mira që ju kanë sjellë këtij Kuvendi sa i përket fushveprimtarisë së të rinjve, gjë për të cilën e përgëzoj drejtoreshën e DKRS-së. Konsideroj se të gjitha subjektet politike dhe të gjitha mekanizmat të cilët integrojnë të rinjtë në këtë Këshill, e kanë për obligim që integrimet t'i bëjnë për së mbari në mënyrë që mos t'i përdorin për qëllime politike, edhe pse ne jemi në dijeni se ka raste që përdoren për qëllime politike sikurse që është në dijeni edhe këshilltari z.Haki Rudari se si partia e tij i përdorë të rinjtë për qëllime politike, për të keq madje.

z.Bahri Selimi, theksoi, vërtetë se Këshilli rinorë në Komunën e Podujevës është i politizuar, nuk kemi çfarë të bisedojmë fare ngase skajshmërisht është e politizuar dhe për këtë çështje mendoj se është e tepërt të flasim më tepër, ndërsa se a jemi ne LVV-ja subjekt politik që t'ju japim hapësirë të rinjve, i them parafolësit se Lëvizja Vetëvendosje e ka dëshmuar këtë ku mbi 80% të strukturës së saj e ka të rini, dhe kjo hapësirë e dhënë tregon se ne nuk e kemi as të ndarë forumin rinorë por e konsideron të barabartë me të gjitha strukturat tjera. Prandaj unë konsideroj se kjo propozim Rregullorë duhet të votohet dhe për këtë nuk ka dyshim, por sa i përket politikës, ajo do të vazhdoj ashtu siç ka qenë edhe më parë.

znj.Mrika Thaqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime dhe përgjigje rreth pyetjeve dhe çështjeve të ngritura nga disa parafolës. Fillimisht i përgjigjem këshilltarit z.Flakron Gashi, mënyra e njohjes së KVRL-ve është e rregulluar në Udhëzimin Administrativ për mënyrën e njohjes së këtij Këshilli nga ana e Kryetarit të Komunës, ndërsa në nenin 11 të propozim Rregullores në fjalë është përfshirë çështja që ka të bëjë me Ligjin për lirinë e asociimit në OJQ. Sa i përket politizimit të të rinjve që e ceku z.Haki Rudari, unë nuk di se kush është ka i politizon të rinjtë, Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit që i fton në debate publike në mënyrë që edhe ata të jenë kontribut dhënës në këtë akt, apo ju të cilët nuk i lejoni të marrin pjesë në këto debate, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për të cilat këshilltari në fjalë i përmend, nuk di se ku i merrni, nëpër shtëpitë e tyre apo ku.

z.Haki Rudari, theksoi, unë dua t'i them drejtoreshës parafolëse se në takimin që e keni mbajtur në Shajkoc, në ora 15;00 keni marrë në mbledhje tri nxënëse të shkollës fillore të klasës së nëntë, gjë e cila është kundër çdo Rregulloreje, kjo është e vërteta, unë kam edhe emrat e atyre

nxënëseve që kanë marrë pjesë me imponime. Sa i përket asaj që kolegu z.Mirsad Kamerolli e tha, unë i them se nuk është keqpërdorim i rinisë kur rinia del dhe tregon një origjinalitet ose një të vërtetë, përkundrazi ajo është një pjekuri e rinisë që rinia sot nuk i përkrah dhe nuk i dëshiron më të këqijat si dhe nuk shkon pas dallave dhe klientelizmit më, dhe këtu është veçoria e Lëvizjes Vetëvendosje ku në këtë Lëvizje rinia ka një hapësirë të lirë të veprimit.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, në një mbledhje të këtij Kuvendi rreth 5-6 muaj më parë, në këtë foltore e kam potencuar që, në të gjitha subjektet politike dëshirojmë ngapak që t'i devijojmë gjërat, por nuk mund ta pranoj kur dikush e thotë se tjerët e bëjnë kurse ne jo sepse edhe subjekti i parafolësit e bënë po aq sa e bëjnë të gjitha tjerat.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot kur para vetës kemi një propozim Rregullorë për procedurat e themelimit dhe funksionalizimit të Këshillit të Veprimit Lokal Rinorë, konsideroj se me këtë ne përmbushim një obligim ligjor që për bazë ka ligjin dhe Udhëzimin Administrativ përkatës që rregullojnë këtë materie. Ndërsa i nderuari Kryesues i Kuvendit, në bazë të asaj që po dëgjoj deri tani nga disa parafolës, më duket një kahje krejt tjetër ku pothuajse sikur ka filluar gara se cili subjekt më shumë e cili më pak keqpërdorin rininë politikisht, madje pati edhe akuza të drejtpërdrejta në adresë të drejtoreshës së DKRS, nuk dëshiroj ta mbroj atë, mirëpo nëse drejtoresha në fjalë ka marrë ose ka kushtëzuar ndokënd ashtu siç u potencua, ju lus ta bëni publike atë gjë, ngase nuk i lejohet drejtoreshës ta kushtëzoj asnjë nxënëse për pjesëmarrje apo jo në ndonjë takim, mirëpo nëse nuk është ashtu, mos të thuhet gjëra të tilla, ngase nuk besoj që rinia jonë është politizuar deri në atë masë që madje edhe të shantazhohet prej subjekteve politike, por t'iu krijojmë hapësirë dhe kushte që ata të vendosin vetë, rriten vetë, formohen politikisht vetë dhe është shumë e drejtë e tyre të jenë pjesë e skenës politike Kosovare.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, po vërej se nuk ka këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, andaj e hedh në votim propozim Rregullorë në fjalë së bashku me raportin e diskutimit publik nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Pas votimit u konstatua se me 32 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim Rregullorja për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës së bashku me propozimin e paraqitur në raportin e diskutimit publik.

6. Propozimi i Statutit të Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë **- Raporti për zbatimin e diskutimit publik**

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë akt edhe në shqyrtimin e parë që është bërë në këtë Kuvend para dy-tri seancave të gjithë kemi qenë unanim që ky Statut duhet të miratohet, pastaj ka dalë në diskutim publik, është mbajtur debati publik ku edhe ju është përcjellë raporti nga diskutimi publik. Gjithashtu edhe në mbledhjen e KPF-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozim Statut dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke përfshirë edhe propozimet nga raporti i diskutimit publik, nëse ka të interesuar për diskutim unë e hapi debatin, nëse jo, e hedh në votim këtë propozim Statut së bashku me raportin përkatës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet propozim Statuti i Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë, së bashku me propozimet e dhëna në raportin për zbatimin e diskutimit publik.

7. Propozimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale

- Vendimi për vënie në diskutim publik

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë kemi propozimin e Rregullores përkatëse e cila parashihet të del në diskutim publik ku mund të jepen të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet për plotësim - ndryshime të nevojshme ashtu siç parashihet në propozimin e vendimit për vënie në diskutim publik të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu për të njëjtën do të diskutohet sërish, pas kohëzgjatjes së diskutimit publik, me rastin e rishqyrtimit në këtë Kuvend. Kohëzgjatja e diskutimit publik dhe data e debatit publik me qytetarë dhe grupe të interesit është caktuar në mbledhjen e KPF-së por ka mbetur vetëm të caktohet ora e mbajtjes së debatit publik, andaj e hapi debatin, por fillimisht është mirë të jepet një fjalë hyrëse rreth këtij propozimi.

z.Avni Fetahu, drejtor i drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), njëkohësisht Kryesues i Grupit punues për hartimin e propozim Rregullores në fjalë, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi paraparë që këtë propozim Rregullore ta procedojmë në Kuvendin e Komunës përkatësisht për miratimin e propozim vendimit për vënie në diskutim publik të kësaj propozim Rregulloreje me qëllim që të mbahen takime të ndryshme publike me këshilltarët e këtij Kuvendi, me qytetarë, me komunitetin e biznesit dhe me grupe tjera të interesit, në mënyrë që me rastin e shqyrtimit përfundimtar dokumenti final të jetë sa më i kompletuar dhe sa më i pasur sa i përket çështjeve të cilat parashihen në të. Sigurisht jeni në dijeni se aktualisht në fuqi është Rregullorja përkatëse e miratuar në Kuvendin e Komunës në vitin 2010 dhe plotësim ndryshimi i saj i miratuar në vitin 2012 për fushën e biznesit, andaj nga ajo kohë janë bërë disa ndryshime të akteve, andaj edhe është paraqitur nevoja për përgatitjen dhe hartimin e një Rregulloreje të re konform rrethanave të reja që po jetojmë. Qëllim i vetëm i kësaj është të jemi edhe më afër ofrimit të shërbimeve për qytetarët tanë. Propozojmë që diskutimi publik të zgjatë deri më 27 janar 2016 ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 20 janar 2017 duke filluar nga ora 10;00, mirëpo pa e kufizuar diskutimin publik deri në procedimin e serishëm të dokumentit në fjalë për shqyrtim dhe miratim final në Kuvendin e Komunës. Përveç diskutimit publik dhe debateve të ndryshme publike, ekziston mundësia që edhe përmes postës elektronike të paraqiten propozimet, sugjerimet, vërejtjet dhe plotësim ndryshimet e juaja. E ritheksoj edhe njëherë që kjo është vetëm propozim Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba komunale përkatësisht dhe propozim vendim për vënie në diskutim publik të këtij propozimi, andaj presim kontributin e të gjithëve në mënyrë që Rregullorja finale të jetë konform rrethanave që po jetojmë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, konsiderova se është shumë e pakuptim që një dokument bazë të kaloj kështu pa u shqyrtuar fare. Jam në dijeni se edhe ne këshilltarët e Kuvendit mund të marrim pjesë në debate publike, mirëpo jemi në dijeni, edhe nga përvoja, rreth debateve publike dhe efekteve të tyre. Sinqerisht e them se më vie keq që Rregulloja aktuale është në fuqi që nga viti 2010 sepse në këtë Rregullore, Komuna e Podujevës mund të synoj që të arrij vlerën nga të hyrat vetanake ndoshta deri në 2 milion euro, mirëpo edhe të regjistroj borxhet e përvjetshme qytetarëve të vetë, borxhe të cilat nuk do të inkasohen kurrë. Nuk jam në dijeni se kush e ka hartuar Rregulloren në fjalë në vitin 2010 por as atë të vitit 2012, por jam në dijeni se janë miratuar në Kuvendin e Komunës. Mendoj se edhe kjo e tanishmja do të miratohet dhe do të ketë impakt negativ për vitet e ardhshme sepse kjo Rregullore është një kopje e keqe me mungesë të theksuar të profesionalizmit dhe të seriozitetit, përndryshe nuk e them se tërë ky material është konfliktuoz dhe me defekte, por ka shumë gjëra defektuoz brenda saj, andaj më lejoni t'i përmend disa prej tyre. Cili profesionist parasheh të barten autobusët me automjete të ashtuquajtura "marimangë"

me një gjobë prej 70 €, cila është logjika që për një garazh të përkohshme prej 18 m² në pronë private të paguhet 120 € taksë, ndërsa për të njëjtën garazh e cila gjendet në pronë komunale-shtetërore të paguhet 100 € taksë, a mos i bie kjo, ruani oborret e juaja e nxëni pronat shtetërore se ju del më lirë dhe më mirë, apo dëshira për të treguar pak solidaritet social bie në kundërshtim me vetveten sepse në faqen 3 shkruhet, citoj, kërkesa për punësim, pa pagesë, ndërsa në faqen 32 pika 36.3 thuhet, citoj, kërkesa për punësim, 1 €, a i po bie kjo, nëse më voton mua e ke pa pagesë, nëse nuk më voton e ke 1 €, mandej, inkasimi dhe klasifikimi i subjekteve afariste është për "ibret" dhe unë nuk di se çka dhe sa pritni inkasim prej kësaj, pastaj neni 23.7 paragrafi 10 thotë, leje për të hyrë në qytet të automjeteve transportuese mbi 3.5 ton për 24 orë, taksa 25 €, çka nënkupton kjo dhe për cilat pjesë të qytetit bëhet fjalë në këtë rast, sepse thuhet vetëm hyrje në qytet 24 orë, po ashtu në nenin 23.8 paragrafi 8 ku thuhet ekspozimi i reklamave në automjete private me 4+1 ulëse 10 € për m², gjithashtu 23.14 thuhet, rezervimi i parkingjeve komunale dhe publike për të vazhduar, parkingje komunale dhe pastaj në parkingje në shirita të ndara rrugëve dhe trotuareve, dhe kur lexohet kjo nuk di se a bëhet fjalë për Komunën e Podujevës apo për ndonjë Komunë tjetër sepse nuk i kemi këto, mandej për të mbërri kulmin është neni 24.1, ku të nderuar kolegë të më thotë ndokush nga zyrtarët komunal se në cilin ligj e ka gjetur mbështetjen për këtë nen në të cilin thuhet, citoj, për një njësi shtëpi deri në 100 m² me oborr deri në 5 ari, banesë deri në 100 m², lokal afaristë deri në 100 m², garazh, bodrum dhe tokë deri në 1 hektarë duhet të paguaj 150 € në emër të transaksionit të pronës së paluajtshme, për të vazhduar me nenin 31 regjistrimi i pronës dhe posedimit, në pikën 1 thuhet, regjistrimi i pronës dhe posedimi sipas transaksionit mbi bazën e shit - blerjes bëhet sipas vlerave të transaksioneve të kryera, ndërkaq unë nuk e kam të qartë këtu se çka nënkuptojmë me transaksion të pronës e çka me regjistrim të pronës, unë jam në dijeni se më parë prona është bartur dhe pronari është ndërruar me një vendim të Gjykatës dhe Komuna vetëm e ka bërë regjistrimin e saj, kurse tani kjo bëhet atëherë kur noterizohet, ta zëmë, të paguash për vullnetin apo dëshirën e ndokujt 5 ari për ndonjë vikendicë te lagja e "Kodralive" që e merr tokën me 20 ari dhe që do të paguaj 100, do t'i kushtoj ndokujt rreth 700,000.00 € bartja e asaj prone. Të gjithë ne e dimë se gjendjen e pronave dhe tapive e kemi pothuajse kurrfare, dhe kjo çështje është shumë në interes nacional që kjo të rregullohet, mirëpo kjo formë është tepër demotivuese dhe kjo kështu nuk do të rregullohet por do të paraqet probleme në vazhdimësi.

Unë dyshoj se kjo propozim Rregullore do të kaloj kështu siç është, mirëpo meqë Ekzekutivi i Komunës ka konstatuar me nenin 34 të kësaj propozim Rregulloreje, që në Komunën tonë ka derra dhe gomar, atëherë gjithçka është e mundshme.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju informoj se dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ka pasur vërejtje, por të gjitha vërejtje, sugjerimet dhe propozimet e juaja, të qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit të cilat janë të nevojshme dhe që janë në interes të qytetarëve do të merren në shqyrtim respektivisht do të merren parasysh nga ana e Ekzekutivit të Komunës. Vlen të ceket se është edhe mundësia e dorëzimit të vërejtjeve edhe në formë të shkruar përderisa ky dokument është në fazën përgatitore përkatësisht në diskutim publik, ku secili prej këshilltarëve të Kuvendit dhe qytetarët kanë të drejtë t'i dorëzojnë ato.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk kam si të mos citoj fjalët e këshilltarit parafolës që ky dokument është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Komunës së Podujevës, gjegjësisht është dokument i cili kontribuon në rregullimin e shumë çështjeve që janë si tema në përmbajtjen e kësaj propozim Rregulloreje. Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar rrethë këtij dokumenti të propozuar dhe kemi shfaqur mendimet tona për disa defekte të cilat e përcjellin këtë propozim Rregullore ku edhe u zotuan të gjithë anëtarët e KPF-së se meqë kjo

propozim Rregullore është propozuar të vëhet në diskutim publik, në fazat e mëvonshme do të na jepet mundësia që të gjitha ato defekte që i shohim si të arsyeshme për t'i eliminuar, do ta bëjmë një gjë të tillë. Mendoj që në fund duhet ta kemi një Rregullore finale me një standard tjetër për dallim nga kjo që kemi para vetës si propozim, ngase vërtetë ka disa mangësi, qoftë në terminologji, qoftë mos ndarje të barabarta të atyre që janë pjesë apo atyre që kjo Rregullore i sanksionon veprimet e tyre. Me shpresën që në fazën finale të miratimit do ta kemi një Rregullore të përmirësuar, një Rregullore të mirë që do të jetë dokument i të gjithë neve këtu, unë e mbështes që kjo të kalon në diskutim publik dhe njëkohësisht zotohemi se do të japim kontributin tonë në përmirësimin e të gjitha atyre defekteve që ne mendojmë se janë të tilla.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e përsërisë se të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet për plotësim ndryshime do të merren parasysh ngase është në interes të qytetarëve dhe Komunës së Podujevës që Rregullorja të jetë sa më e mirë dhe e kompletuar në të gjitha aspektet e në veçanti duhet të bëhet përpjekje maksimale sa i përket të hyrave vetanake.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), theksoi, një nga këshilltarët parafolës shtroj pyetje se në çka janë bazuar hartuesit e kësaj propozim Rregulloreje për disa çështje konkrete, fillimisht propozimi për hartimin e kësaj propozim Rregulloreje përkatësisht ndërrimin e Rregullores aktuale ka filluar pikërisht nga Ekzekutivi i Komunës ngase kemi parë dhe konsideruar se Rregullorja duhet të harmonizohet me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Sa i përket DPKGJ por edhe shumicën e Drejtorive tjera taksat, tarifat dhe gjobat komunale që janë paraparë në këtë propozim Rregullore janë të bazuara në akte nënligjore përkatëse varësisht nga fushveprimtaria e Drejtorive, shembull, taksa që u përmend 150 € parashihet në ligjin e financave të pushteti lokal, ndërsa sa i përket transaksioneve dhe regjistrimit të pronave, këshilltari z.Lutfi Rexhepi me profesion është ekonomist dhe konsideroj se e din ai se çka do të thotë transaksion dhe çka regjistrim, kurse ne vetëm zbatojmë Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë neni 08/2014 i cili parasheh tarifën përkatëse e cila aplikohet në të gjitha Komuna e Republikës së Kosovës, pra ne nuk e kemi nxjerrë atë. Kështu që vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e ndryshme mund të bëhen nga të gjithë dhe besoj se të gjitha do të shqyrtohen dhe analizohen, mirëpo inicimi i hartimit të një Rregulloreje të re ka filluar nga Ekzekutivi i Komunës ngase Rregullorja aktuale edhe pse është në fuqi bie ndesh me aktet e reja nënligjore të cilat janë nxjerrë nga ana e nivelit qendror pas miratimit të Rregullores në fjalë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim të propozim Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, kohëzgjatjen e diskutimit, datën dhe orën e mbajtjes së debatit publik e propozoi Drejtori i DBPZHR në fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, përkatësisht diskutimi publik të zgjatë deri më 27 janar 2017 ndërsa debati publik të mbahet më 20 janar 2017 duke filluar nga ora 10;00.

8. Propozimi i Vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, po ashtu edhe për këtë propozim vendim në mbledhjen e KPF-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me disa plotësime të cilat mund t'i gjeni në konstatime nga mbledhja e KPF-së. Vlen të theksohet se nga ajo mbledhje ka rrjedh edhe kërkesa që anëtarët e komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cilët nuk janë shërbyes civil, për punën e kryer rreth këtij propozim vendimi, të kompensohen në shumë 50€, kërkesë të cilën ne si KPF e kemi mbështetë dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim, mirëpo nëse këtë e hedhim në votim, atëherë duhet që me akt tjetër ta miratojmë, por që edhe anëtarët e komisionit nuk duhet të marrin pjesë në procedurën e votimi por duhet ta lëshojnë sallën deri sa të përfundon procedura e votimit për shkak të konfliktit të interesit.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, edhe pse nuk jam e prirur të mendoj lokalisht, por si do që të jetë është një projekt në fshatin prej nga unë vie dhe e pash të arsyeshme të marrë fjalën në mënyrë që të adresohem me qëllim që të ritheksoj rendësin e madhe që ka ky projekt i cili përveç të mirave pozitive në aspektin ekonomik që do të sjellë në zbutjen e papunësisë dhe motivacionit për ushtrimin e një veprimtarie të tillë jo vetëm për fshatin Svegël por për tërë Komunën e Podujevës dhe më gjerë edhe në Gollak. Në memoarin e fëmijërisë time ai vend ka qenë totalisht bosh dhe i pashfrytëzuar, andaj tani me vetë faktin që në atë pjesë është ndërtuar një objekt i mirë dhe i cili përveç të mirave që i ceka paraprakisht besoj që është një motivacion shumë i madh që ne sot t'i japim një po të madhe këtij projekti. Marrë shkas nga ky projekt, por edhe njëkohësisht meqë jemi në seancën e fundit për vitin 2016, e don rendi që të mos i shohim gjërat vetëm zi, por të falënderojmë Kryetarin e Komunës z.Agim Veliu për këtë dhe shumë projekte tjera madhore që i ka sjellë përgjatë këtij viti për të gjithë qytetarët Llapjan, po ashtu falënderoj edhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës i cili përmes udhëheqjes së seancave të këtij Kuvendi ka përçuar tek ne mesazhin e tolerancës dhe mirëkuptimit ku njëkohësisht ka qenë edhe shumë i durueshëm që rrjedh edhe nga vetë natyra e tij, gjë e cila duhet të vlerësohet, pasta duhet të përshëndetet dhe të falënderohet edhe Nënkryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive komunale të cilët kanë qenë gjithmonë të gatshëm t'iu përgjigjen kërkesave tona, e padyshim një falënderim shumë të madh e kam për të gjithë kolegët asambleistë pavarësisht subjekteve dhe rreshtimeve politike që kemi gjithmonë kemi qenë të mirë kuptueshëm për njëri-tjetrin dhe asnjëherë nuk ka mbizotëruar ndonjë fyerje apo diçka e ngjashme, pra edhe për këtë dua t'ju falënderoj dhe njëkohësisht ju uroj festat.

z.Bahri Selimi, theksoi, kjo që unë do ta them në vazhdim mendoj se është shumë serioze, sa i përket rëndësisë që ka ky projekt nuk e diskutojmë fare sepse ka rëndësi të madhe ky projekt qoftë punësimi, grumbullimi dhe shumë faktorëve tjerë që fatkeqësisht po mungojnë në Komunën e Podujevës. Ajo që më shtyri të marrë fjalën ka të bëjë pikërisht me këtë propozim të bërë nga Kryetari i Komunës për miratimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së Komunës, Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël, mirëpo kur e shoh se ky propozim do t'i nënshtrohet ankandit publik dhe do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i ngritur më parë nga ky Kuvend, nuk di se si do të dal në ankand publik kur kjo punë është veç e kryer. Para një kohe vetë Kryetari i Komunës ka qenë në atë objekt dhe ka përruar hapjen e atij vendgrumbullimi, do të thotë që ai vendgrumbullim është përruar dhe puna është duke u zhvilluar aty, a ka filluar apo jo puna është çështje krejt tjetër, mirëpo përrurimi

është bërë, andaj kur një projekt përurohet dhe fillon punën, si ka mundësi që pastaj t'i nënshtrohet një ankand publik ku në atë ankand do të marrin pjesë edhe të interesuar të tjerë për ta marrë në menaxhim atë vendgrumbullim, dua të them ka shumë biznese të cilat mund të aplikojnë përderisa këtu shumë qartë thuhet që procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes konkurrencës së hapur publike përkatësisht përmes ankandit publik, dhe tani për këtë kam dilema, në këtë ankand a do të merr pjesë vetëm ai i cili e ka përfituar këtë projekt dhe është duke punuar apo do të marrin pjesë edhe qytetarë tjerë, nëse merr pjesë vetëm një person atëherë mund të themi se nuk është ankand, por nëse marrin pjesë dy a më shumë i bie të jetë ankand, pastaj shtrohet pyetja, çka nëse e fiton dikush tjetër dhe nuk e fiton ai, a po na del kjo që është krejt një keqpërdorim dhe një projekt i cili udhëheqet nga dikush që e ka marrë lejen shumë më herët në këtë Komunë.

Po e ritheksoj edhe një herë se rëndësia e këtij projekti është shumë e madhe, ne do ta mbështesim dhe do ta përkrahim çdo biznes që vie në Komunën e Podujevës, mirëpo për procedurat e dhënies në shfrytëzim jemi dëshmitarë që unë shumë herët e kam ngritur zërin ngase vazhdimisht mendoj se pronat e Komunës jepen në mënyrë shumë të parregullt dhe jashtë mënyrës së rregulluar me legjislacionin përkatës.

z.Fidan Rekalu, theksoi, ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar lidhur me këtë propozim vendim dhe të gjithë kemi qenë të një mendimi se ajo qendër duhet të gjallërohet sepse vlerësohet të jetë një objekt i një rëndësie të veçantë, andaj nuk bën të jetë i pashfrytëzuar ose eventualisht të dështoj një objekt i tillë i cili është i rëndësishëm për Komunën e Podujevës. Ajo çfarë kërkova në mbledhjen e KPF-së është se përfituesi është mirë të jetë ndokush që e gjallëron edhe më shumë atë hapësirë, mirëpo edhe për këtë çështje u sqaruam se çështja e cekur është e rregulluar shumë mirë me ligjin dhe Rregulloren për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, pra dua të them se çështjet që kanë të bëjnë me dhënien e kësaj qendre në shfrytëzim janë të rregulluara me dispozita ligjore, andaj kërkoj që vetëm të zbatohen ato dispozita dhe procedura, besoj që gjithçka do të jetë në rregull.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po ta shikojmë parimisht, mendoj se Kryetari i Komunës është ngutur me përrurimin e asaj qendre, nëse ka pasë në plan ta sjellë një vendim të tillë në Kuvendin e Komunës, pra ka qenë hap i ngutshëm dhe i pamatur që është përruruar një objekt pa u sjellë propozimi i vendimit në Kuvendin e Komunës. Ne të gjitha Grupet e këshilltarëve e kemi mbështetë këtë projekt sepse ajo qendër duhet t'i jepet në menaxhim ndonjë biznesmeni i cili duhet të jetë serioz, i cili e funksionalizon dhe i cili paguan qiranë komunale konform dispozitave ligjore në fuqi. Sa i përket Komisionit përkatës për dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim unë edhe në mbledhjen e KPF-së e kam cekur se ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së nuk kemi anëtarë, mirëpo besoj shumë se anëtarët tjerë z.Bahri Selimi, z.Naim Çunaku dhe të tjerët se të njëjtit do ta kryejnë punën mirë ashtu si duhet ngase konsideroj se procedurat e ankandit e rregullojnë mjaft mirë këtë çështje dhe qartë specifikohet që ai i cili ofron shumën më të madhe të pagesës është përfitues i pronës për ta shfrytëzuar. Mbetet obligim i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë që të inkasoj qiranë, po ashtu mbetet obligim që në kontratën e nënshkruar mes Kryetarit të Komunës dhe përfituesit - qiramarrësit të specifikohet masat që do të ndërmerren Komuna në rast se nuk paguhen obligimet, sikurse që ka ndodhur me prona tjera shembull, bilbordet në qytet, ish hotel "Llapi" ose restorant "Mileniumi" të cilat me vite të tëra nuk paguajnë qira ndërsa nuk ndërmerren kurrfarë hapash. Përndryshe ne e përkrahim këtë propozim vendim përkatësisht që kjo çështje të kalojë në ankand publik, por mbetet obligim ligjor i komisionit përkatës se si i vlerëson ofertat. Ne si Grupe të këshilltarëve nuk mund ta refuzojmë

një propozim të tillë dhe ta lëmë atë qendër të pa funksionalizuar pavarësisht që përrurimi i asaj qendre është bërë me një hap të pamatur dhe të ngutshëm.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, për ta mbështetur atë që më parë e ceka, nuk është aspak e vërtetë që dikush e ka në shfrytëzim atë objekt, siç u tha nga një parafolës. Ne jemi në dijeni se në këtë Kuvend fillimisht kemi marrë një vendim për atë pronë – tokë, pastaj falë bashkëpunimit të mirë të Komunës së Podujevës të udhëhequr nga z.Agim Veliu, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionit Evropian në Kosovë, është bërë ky investim për ndërtimin e qendrës dhe inventarizimit me inventar brenda qendrës. Ajo çka ka ndodhur atë ditë ka qenë një ceremoni që do të thotë aspekt ceremonial i inaugurimit të asaj qendre, dhe nuk është e vërtetë ajo që u tha se dikush është duke punuar aty, por në atë ceremoni ka marrë pjesë një Shoqatë e cila në mënyrë ceremoniale ka sjellë disa produkte me të cilat e njëjta prezantohet nëpër panairë dhe e ka si veprimtari të vetën.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot kur para vetës kemi një propozim vendim sipas të cilit mundësohet promovimi gjegjësisht lëshimi në funksion i një objekti i cili ka qenë investim i një donatori në bashkëpunim me Komunën e Podujevës, ato janë mjete të Bashkimit Evropian dhe kësaj Komune. Nuk dëshiroj të flasë për qëllimin e këtij propozimi sepse kemi diskutuar kur më parë është marrë një vendim rreth kësaj prone, mirëpo këtu u ngritën disa dilema të cilat për dy arsye më shtynë të marr fjalën, meqë jam anëtar i Komisionit vlerësues për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe para së gjithash anëtar i këtij Kuvendi, prandaj para këtij Kuvendi po paraqesë realitetin sipas këndvështrimit tim gjegjësisht perspektivës që unë e kam parë atë proces.

U tha se në atë objekt ka filluar puna, unë nuk kam njohuri se dikush ka filluar punën në atë objekt dhe nuk dyshoj në atë, mirëpo edhe nëse ndokush ka filluar punën, pavarësisht se kush është ai, ne sot po marrim një vendim që atë objekt ta japim në shfrytëzim afatshkurtër, kushtet, kriteret dhe rregullat tjera, për ata të cilët pretendojnë të marrin prona publike në shfrytëzim, përcaktohen me ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronave publike, dhe aktet tjera nënligjore përkatëse, ndërsa para ligjit besoj se të gjithë janë të barabartë, për të mos përdorur shprehjen që nga njëherë ligji është si "llastik", mirëpo të paktën mua si anëtar i atij komisioni nuk më lejohet të them se nuk po përmbushet ligji apo po shkelet ligji, ashtu siç u tha nga një parafolës. Fundja jemi të deleguar në atë komision për ta mbrojtur ligjshmërinë, ndërsa në rast se ndokush pretendon se ka shkelje, e ka të drejtën të prononcohet publikisht dhe të vazhdoj me procedura të tjera në vendet ku janë të përcaktuara për deklaram të shkeljeve ligjore.

E falënderoj shefin e Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së i cili e shprehi besimin e tij në anëtarët e komisionit, në veçanti në mua sepse u përmend emri im ku u potencua se z.Naim Çunaku është në atë komision si rezultat i grupimit të PDK-së, nuk jam këtu për të kundërshtuar por meqë edhe në fillim të kësaj seance u hap një formë e këtij debati për të cilin thënë të drejtën edhe unë tani po e akuzoj si të tjerët Kryesuesin e Kuvendit që nuk e paraqiti para Kuvendit të Komunës se Komitetet janë të përcaktuara ose bazën ligjore e kanë barabarësinë në përfaqësimin politik, ndërsa Komisionet nuk kanë përcaktim partiak dhe në bazë të ligjit dhe Udhëzimit Administrativ ndërtohen në Kuvendin e Komunës sipas vullnetit të Kuvendit, e jo në bazë të përkatësisë politike. Për ta ilustruar këtë shembull po e potencoj një rast, ku kemi pasë para vetës propozimin për formimin e komisionit të ankesave për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, unë kam qenë ai i cili e kam propozuar z.Rafet Llapashticën të jetë anëtar i atij komisioni ndërsa ka qenë propozimi tjetër nga LVV-ja që anëtare në atë komision të jetë znj.Adelina Stublla dhe propozimi tjetër ka qenë për dy anëtarë nga radhët e LDK-së, ku ne është dashur të zgjedhim tre anëtarë dhe ky Kuvend ka vendos të formohet komisioni përkatës pa përfaqësues të PDK-së, për të mirë apo për të keq nuk jam unë ai i cili e vlerësoj vullnetin e anëtarëve të këtij Kuvendi.

Krejt në fund po e them, po ta dijë që është paraprakisht përfituesi i kryer, unë nuk do të jem pjesë e atij komisioni, por nëse ju i nderuar këshilltar z.Bahri Selimi ke paragjykime ose e dinë se kush do të jetë fituesi, unë publikisht po ju them tani, askush nuk jua ndalon juve që ta shtyni ndonjë familjarë tuajin që të konkurren me kushte më të favorshmet për Komunën, edhe pse ndoshta mund të jetë konflikt interesi, dhe nëse komisioni vlerëson ndryshe, atëherë e ke të drejtën të flasësh, por të paragjykoni, mendoj se nuk është në rregull.

z.Haki Rudari, theksoi, shumica e këshilltarëve parafolës rreth kësaj pike të rendit të ditës nuk diskutuan për këtë temë, pati këshilltarë të Kuvendit që bëri falënderime, kolegu parafolës u mor me përbërjen e komisioneve çështje të cilat nuk janë në rend dite. Kolegu nga radhët e LVV-së i cili është edhe anëtar i komisionit përkatës i potencoj të gjitha. Ne realisht në fillim kur është dhënë ajo pronë e kemi përkrahur pa kurrfarë hezitimi dhe kudo që investimet janë në dobi të qytetarëve LVV do t'i përkrahë ato, pavarësisht qëndrimeve të Grupeve tjera politike, por realisht nuk është hera e parë, madje kolegu nga radhët e Grupit G-Plus i cili është edhe anëtar i Komisionit, që kemi vërejtje në atë komision për arsye se ka pas raste dhe këtu është thënë edhe nga Ekzekutivi i Komunës, që është dhënë pronë komunale në shfrytëzim njerëzve të cilët i kanë borxhe Komunës së Podujevës. Çështja tjetër që edhe kolegu e tha është ajo që unë edhe në mbledhjen e KPF-së e kam thënë, çka në të ardhmen. Pajtohem plotësisht që projekti është i mirë, por mos vallë në të ardhmen ajo qendër do të vie deri te mbyllja, apo ndoshta është përgatit për ndonjë person kur të gjithë jemi në dijeni dhe është fakt se me rastin e inaugurimit të atij objekti, në media ka qenë fotoja e Kryetarit bashkë me disa punëtor duke punuar me jete mbrojtësi të punës.

z.Naim Çunaku, theksoi, parafolësi ju drejtua Kryesuesit të Kuvendit se po lejon të diskutohet jashtë rendit të ditës dhe në një formë u aludua pas diskutimit tim paraprak. Unë konsideroj se plotësisht kam qenë në kuadër të rendit të ditës sepse në këtë pikë kemi propozim vendimin miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, Qendrën për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël, dokument në të cilin disa herë potencohet edhe komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, andaj unë diskutova edhe nga cilësia e anëtarit të atij komisioni dhe sqarova disa dilema rreth komisionit përkatës.

z.Kadri Avdiu, theksoi, desha të ndërlihem me atë që z.Bahri Selimi në diskutimin e tij në një formë e tha se për këtë çështje është prerë shiriti. Kur i zoti i shtëpisë e merr ndokund ndonjë vendim dhe pastaj kthehet në familje dhe thotë se e kam marrë këtë vendim me pajtimin e tyre, besoj se nuk është ndonjë telashe.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, meqë secili prej nesh mendon me kokën e vetë mund të lindin edhe dyshime të ndryshme, por meqë drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është prezentë këtu, unë kam pyetje konkrete për atë, ku janë çelësat e objektit i cili është përruar, e them këtë për arsye se Kuvendi i Komunës duhet të bindet që objekti nuk është duke punuar, unë nuk po dyshoj a është apo jo duke punuar sepse nuk jam pjesë e komisionit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, komision i cili e ka të drejtën e plotë të vizitoj atë objekt dhe të konstatoj se është duke punuar ai objekt apo jo. Objekti aktualisht është në pronësi të Komunës, andaj, a janë çelësat e objektit në Komunë apo ku gjenden, pra dëshiroj ta mbylli debatin rreth objektit sepse ne jemi persona zyrtar dhe nëse çelësat e objektit janë tek t'i drejtor është mirë ta bindni komisionin. Pra edhe njëherë Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështetë propozimin që objekti përkatës të jepet në shfrytëzim me qira ofertuesit më të mirë ashtu siç rregullohet me ligj, ndërsa konsideroj se komisioni përkatës ka për obligim të vlerësoj ofertën më të mirë dhe më të favorshme financiarisht duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e

procedurave ligjore. Pra nëse në objektin e ndërtuar vërtetë nuk është duke punuar ndokush, atëherë dikush nga Ekzekutivi i Komunës duhet të na bind neve si Kuvend.

z. Shaban Osmani, theksoi, meqë u diskutua mjaft gjerë për këtë pikë të rendit të ditës, edhe unë konsideroj se ai projekt është madhor dhe i qëlluar i cili për qëllim ka grumbullimin dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve. Sa ai përket asaj që u cek rreth përrurimit të atij objekti, duhet të sqarohemi sepse Kryetari i Komunës e ka bërë përrurimin e ndërtimit të objektit përkatës, por nuk është bërë përrurimi i dhënies në shfrytëzim. Andaj komisioni përkatës është i formuar, pastaj shpallet ankandi publik, bëhet vlerësimi dhe procedohet me çështje tjera, në këtë aspekt do të kërkoja nga komisioni përkatës që kushtet dhe kriteret e dhënies të shpallen më shumë në favor të punësimi, kush punëson më shumë njerëz, se sa në favor të përfitimit të Komunës se kush ofron shumë më të madhe për qiranë, pra së paku punësim për 10 punëtor dhe gjatë sezone kush ofron më shumë mundësi punësimi. Sjellja e donatorit të jashtëm përkatësisht realizimi i këtij projekti dihet se është meritë Kryetarit të Komunës, andaj konsideroj se është projekt i qëlluar dhe nuk ka nevojë të thuhet gjëra të ndryshme çfarë u thanë.

z. Nexhmi Rudari, Nën kryetar i Komunës, theksoi, lidhur me këtë temë u shtruan shumë pyetje nga një pjesë e parafolësve, prandaj mora fjalën me qëllim që të jap përgjigjet adekuate.

Projekti në fjalë e ka një menaxher dhe objekti në fjalë e ka një roje, dhe çelësin e objektit e kanë menaxheri dhe roja derisa të bëhet inaugurimi zyrtar i prodhimit, në fakt i grumbullimit, ndërsa rreth përrurimit që u përmend, atë ditë ka qenë ceremoni zyrtare e pranimit - dorëzimit të objektit, sepse në ceremoninë zyrtare të pranimit - dorëzimit të objektit është mundësuar investitorit, në këtë rast Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Komunës, t'i kryejnë pagesat ngase në mungesë të raportit të pranimit – dorëzimit zyrtar nuk mund të kryheshin pagesat. Çështjet tjera besoj se u sqaruan dhe nuk dëshiroj të zgjerohem më tutje. Atë që po e them në vazhdim ashtu edhe e ndjejë dhe kam për obligim ta them edhe para juve, edhe në emër të Kryetarit të Komunës, të falënderoj Kryesuesin e Kuvendit, shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, gjithë këshilltarët/ët e Kuvendit, sepse kritikën dhe mbështetja juaj kanë qenë motivacion i Ekzekutivit të Komunës në aspektin e përmirësimit të punëve, po ashtu të jeni të bindur se rekomandimet dhe sugjerimet e juaja kanë qenë në favor të përmirësimit të performancës së Komunës. Nuk dëshiroj të marrë si pikë referente as Kuvendin e Republikës së Kosovës, as Kuvendin e Kryeqytetit – Prishtinës, por jam shumë i bindur dhe besoj se ndaj mendimin me shumicën prej juve që asnjë Kuvend komunal në nivel të Kosovës nuk ka pas bashkëpunim më të mirë se sa ky Kuvend dhe unë mendoj që kjo frymë e juaja e mbështetjes dhe kritikave duhet të vazhdojë edhe në vitin 2017. Për fund, më lejoni që edhe në emër të Kryetarit të Komunës, t'ju uroj festat e fund vitit.

z. Bahri Selimi, theksoi, unë në fillim të diskutimit, këtë temë e fillova me qëllim të mirë, por si duket u keqinterpretua. Shumë qartë dhe decidivisht e potencova se ne jemi për investime dhe pajtohemi që projekti në fjalë është madhorë, por jemi kundër disa procedurave të cilat kanë ndodh edhe tani pas përrurimit të atij objekti. Pajtoj me Grupin e këshilltarëve të LDK-së të cilët po e mbrojnë Kryetarin e Komunës sepse është drejtë e tyre dhe i njëjti është edhe Kryetar i partisë së tyre, por megjithatë kur Kryetari i Komunës ka bërë përrurimin, unë nuk e kam parë që është përruruar vetëm objekti por kam parë edhe disa punëtor duke punuar me uniforma përkatëse të cilat përdoren për përrurimin apo punën që bëhet brenda një objekti të tillë, dhe kjo ka qenë edhe nëpër media.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të hedhet në votim ky propozim vendim, kërkoj nga anëtarët e komisionit vlerësues të cilët janë edhe këshilltarë të Kuvendit që ta lirojnë sallën në mënyrë që mos të jenë prezent në procedurën e votimit për shkak të konfliktit të interesit, ngase siç u njoftuam më parë në mbledhjen e KPF-së, krahas këtij propozim vendimi, është

rekomanduar edhe kompensimi në shumë 50 € për anëtarët e komisionit vlerësues, të cilët nuk janë shërbyes civil. Andaj hedh në votim propozim vendimin përkatës dhe rekomandimin përkatës të KPF-së për kompensim të anëtarëve të komisionit në fjalë të cilët nuk janë shërbyes civil.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, asnjë votë kundër dhe 2 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël, duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Njëkohësisht miratohet edhe propozimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cilët nuk janë shërbyes civil.

9. Propozimi i vendimit për miratimin e Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se keni pasur mjaft kohë ta shqyrtoni këtë propozim plan në të cilin janë përfshirë kryesisht pika – tema të cilat janë të përcaktuara me ligje dhe akte tjera nënligjore që të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës përgjatë një viti fiskal, mirëpo janë paraparë edhe pika tjera të nevojshme për shqyrtim në Kuvend. Vlen të theksohet se gjatë vitit mund të ketë për shqyrtim edhe propozime, dokumente dhe akte tjera të rëndësishme sipas nevojës, por edhe propozime dhe kërkesa me rëndësi ose të nevojshme të këshilltarëve apo Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, të cilat mund të bëhen sot në këtë mbledhje por edhe gjatë vitit, andaj e hap debatin.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, në vitin që po e lëmë pas (2016) kam kërkuar nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, një informatë rreth kujdesit primar shëndetësorë, gjë të cilën nuk e kemi marrë asnjëherë. Andaj kërkoj që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 të na sjellët një informatë e tillë rreth shëndetësisë ngase besoj se kemi për çka të debatojmë, si për gjëra të mira ashtu edhe për gjëra të këqija.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua propozim Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2017, duke përfshirë edhe propozimin e këshilltares parafolëse.

10. Të Ndryshme

Nuk pati këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, *Kryesuesi i Kuvendit duke jua uruar vitin e ri 2017, e konstatoi këtë mbledhjen të përfunduar, dhe njëkohësisht i ftoi këshilltarët e Kuvendit dhe Ekzekutivin e Komunës në një koktej rasti për fund vit*

Mbledhja përfundoi në orën 12;25

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-006-93299
Podujevë,
28 dhjetor 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**